

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	09.09.2019
REFERENC-Ë:	19/1959/2-288/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Gurishta-Zh." Sh.p.k.Zhur, Prizren.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 19/1959/2-288/DMMU, dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of
the General Secretary*

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 21 paragrafi 4 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ i kërkesës së kompanisë "Gurishta-Zh." Sh.p.k.Zhur, Prizren me nr.prot.: 19/1959/2-288/DMMU për Pëlqim Mjedisor, për gurthyesin me seperacion në Zhur, Prizren.

A r s y e t i m


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë "Gurishta-Zh." Sh.p.k.Zhur, Prizren për Pëlqim Mjedisor, për gurthyesin me seperacion në Zhur, Prizren, vlerëson si në vijim.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se mungon dokumentacioni në vijim:

- Pëlqimi i Komunës
- Për tu shqyrtuar kërkesa e Juaj, keni qenë të obliguar të sjellni dokumentacionin e lartcekur.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ju ka dërgua kërkesën më datë 20.06.2019 , për **Plotësimin e dokumentacionit**, ku në bazë të nenit 21, paragrafët 2. dhe 3. të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214, është përcaktuar

Faqe 2 nga 3



afati ligjor, të cilin afat nuk e keni respektuar për sjelljen e dokumentacionit të lartcekur.

Prandaj, **Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ** i kërkesës për Pëlqim Mjedisor me nr.prot.: 19/1959/2-288/DMMU, të Kompanisë "Gurishta-Zh." Sh.p.k.Zhur, Prizren për Pëlqim Mjedisor, për gurthyesin me seperacion në Zhur, Prizren në ngastrën kadastrale nr.02402-1, Zona kadastrale Zhur, komuna e Prizrenit, vlerëson si në vijim.

Bazuar në mangësitë e dokumentacionit administrativ, si dhe në pamundësinë e marrjes së vendimit përfundimtar, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/1959/2- ZSP/455/19 datë:09.09.2019

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/ Department of Environment Protection
and Waters/ Departament za Zaštitu Sredine i Voda

DATE/A:	09.09. 2019
REFERENC-Ë:	19/1959/2-288/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit të Mjedisit dhe Ujërave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Bazuar në kërkesën e bërë nga: "Gurishta-Zh." Sh.p.k.Zhur, Prizren, me nr. prot.: 19/1959/2-288/DMMU ,ne kemi shqyrtuar Raportin për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga ju dhe Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka vendosur sikurse ne vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1